

# ALBPETROL SH.A.

Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

Aplikanti: Kristina Zote



## Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur .....	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) - Aktivet .....	8
Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) – Detyrimet dhe Kapitali .....	9
Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse .....	10
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto .....	11
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare .....	12
Shenime shpjeguese për Pasqyrat Financiare .....	13
1. Informacione të përgjithshme .....	13
2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) .....	16
3. Bazat e përgatitjes .....	16
4. Përmbledhje e politikave kontabël .....	18
5. Shenime të tjera shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare .....	23

Apolitent' r. Zishues  
KDO  
KDO

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Drejtuesit dhe Aksionerin e ALBPETROL sh.a.

## Opinion me rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albpetrol sha (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, si dhe një përmbledhje të politikave kontabel më të rëndësishme kontabel.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në "Bazat për Opinionin me rezerve", pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Bazat për Opinionin me rezerve

Ne lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë ALBPETROL SHA, paraqesim rezervat tona të renditura më poshtë sipas rendit të rëndësise së tyre:

1. Në shënimin 8 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2017, "Aktivet Afatgjata Materiale" paraqiten me vlerën 46,358,257,688 lekë (2016: 46,621,285,159 lekë). Shoqëria prej vitesh aplikon norma manaxheriale shumë të ulta për amortizimin e aktiveve afatgjata materiale, këto norma bazohen në një vendim të Keshillit Mbikqyres të vitit 2007. Ne gjykojmë se normat manaxheriale të amortizimit nuk përputhen me realitetin e zhvleresimit dhe të amortizimit të aktiveve afatgjata materiale. Metoda e amortizimit e përdorur për një AAM, në pajtim me SNK 16, duhet të rishihet të paktën çdo fundviti financiar dhe nëse ka një ndryshim të rëndësishëm në tiparin e pritshëm të konsumit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktiv, metoda duhet të ndryshohet për të pasqyruar tiparin e ndryshuar. Në "Kapitalet e Veta", vlera në zërin "Rezerva nga rivleresimi" i "Aktiveve Afatgjata Materiale", nuk ka levizje për një kohë të gjatë dhe nuk kryhet marrja e tyre në të ardhurat gjithëpërfshirëse. Shoqëria ka kryer një rivleresim të ri të AAM (loke, ndërtesa, makineri, pajisje) dhe raporti përkatës mban datën 20.02.2017, sipas kësaj raporti, vlera e drejtë për AAM-të (loke, ndërtesa, makineri, pajisje) në datë 01.01.2015 është 35,321,991,606 lekë, ndërsa vlera kontabel e AAM në atë datë raportohej 48,153,933,958 lekë, pra vlera e drejtë rezulton rreth 27% më e ulët. Ky rivleresim si dhe ndikimi i tij, nuk është paraqitur në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2017.

2. Në shënimin 4 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2017 inventari paraqitet në vlerën 2,978,209,024 lekë (2016: 4,148,231,610 lekë).

a) Për shkak se ne u emëruam si auditues në datën 15 Dhjetor 2017, ne nuk ishim të pranishëm në procesin e inventarizimeve vjetore të cilat shoqëria i kishte realizuar në datën 30 Shtator 2017. Me gjithë procedurat e tjera të zbatuara, për shkak edhe të natyrës së regjistrimeve të shoqërisë, ne nuk mundëm të siguroheshim nëpërmjet evidencës së duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me sasinë e inventarit në datën 31 Dhjetor 2017.

Aplikantët: 

- b) Në pajtim me parashikimet në SNK 2 "Inventarët", kur inventarët dëmtohen, janë bërë lërisht ose pjesërisht të vjetruar ose nëse çmimet e shijes së tyre kanë rënë, shoqëria duhet të kryejë zhvlerësimin e inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme. Shoqëria trashëgon inventare të vjetër në vlerën 588,122,931 Lekë dhe ka njohur zhvlerësime për inventaret në vlerën 137,487,469 Lekë në periudha të mëparshme, megjithatë, nuk është kryer një test i vlerësimit të inventarit dhe llogaritja e zhvlerësimit në datën e pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2017.

Për këtë arsye, ne nuk mund të përcaktojmë efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, si rrjedhojë e rregullimeve që mund të jenë të nevojshme të kryhen për inventaret.

3. Në shenimin 3.4, "Te tjera të drejta të arketueshme", pasqyra e pozicionit financiar, paraqitet në vlerën 4,845,629,565 Lekë (2016: 5,154,526,366 Lekë). Në këtë veprë përfshihen:

- a) Te drejta ndaj të tregëve për kontrata hidrokarbure, në vlerën 2,497,785,582 lekë (2016: 3,348,670,119 leke). Këto vlera përfaqësojnë vlerën perkatese të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është levruar fizikisht në depozitat e Albpetrolit. Një pjesë e këtyre të drejtave të arketueshme të vlerësuar më 31.12.2017, me një vlerë prej 1,704,308,090 leke nuk konfirmohen si detyrim nga ana e kontraktoreve dhe janë kundërshtuar në rruge ligjore prej tyre. Shoqëria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.
- b) Te drejta ndaj sigurimeve shoqërore në vlerën 116,463,402 leke në datën 31 Dhjetor 2017 (2016: 116,293,922 leke). Ne nuk na u vune në dispozicion informacione të mëtejshme lidhur me këto të drejta të arketueshme, për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të krijojmë siguri të arsyeshme për ekzistencën dhe vlerën e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë.
- c) Te drejta ndaj të tregëve për hua të dhena me kontrata huaje sipas urdherave të aksionarit në vlerën 316,070,762 leke në datën 31 Dhjetor 2017 dhe 109,879,332 lekë në datën 31 Dhjetor 2016. Për shkak se njesitë për të cilat janë dhene huatë janë shoqëri të cilat i kanë pushuar aktivitetet dhe funksionojnë në konservim, nuk shihen mundësi për arketimin e tyre.
- d) Aktive të tjera mbi një vit në vlerën 1,223,275,680 leke në datën 31 Dhjetor 2017 dhe 1,218,005,438 lekë në datën 31 Dhjetor 2016. Në këtë pozicion paraqiten shuma të identifikuar si mungesa, firo si dhe vlera të tjera të lidhura me mardheniet të vjetra përpara transformimit të shoqërisë. Ne nuk na u vune në dispozicion informacione të mëtejshme lidhur me këto të drejta të arketueshme, për rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të krijojmë siguri të arsyeshme për ekzistencën dhe vlerën e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë.

4. Në shenimin 3.1, "Te drejta të arketueshme tregtare", në pasqyrën e pozicionit financiar, paraqitet shuma 16,232,705,925 lekë në datën 31 Dhjetor 2017 (2016: 15,831,502,434 leke). Në këtë vlerë përfshihen të drejta të arketueshme me të vjetra se 365 ditë në vlerën 15,246,757,626 leke në datën 31 Dhjetor 2017 (2016: 14,857,666,943 leke). Për këto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për mundësinë e arketimit të tyre. Shoqëria nuk ka bërë teste zhvlerësimi dhe nuk ka llogaritur zhvlerësim për kërkesat e arketueshme. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund të rezultojnë nga korigjimet e mundshme të tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2017.

Aplikant: Kristina  
Loka

4

5. Në shënimet 13.4 dhe 17.4 të pasqyrave financiare, gjendja e llogarive tregtare të pagueshme afatshkurtra paraqitet në vlerën 575,167,201 Lekë, dhe gjendja e llogarive tregtare të pagueshme afatgjata në vlerën 8,228,525,366 Lekë. Për këto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave të letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2017.

6. Bazuar në informacionin që na është vënë në dispozicion, nuk rezulton që shoqëria për ceshitet gjyqësor me palet e treta, të këta përloganitur rrezik dhe paraqitur provizion në pasqyrat financiare të vitit financiar të vitit 2017. Gjatë periudhës 2017 shoqëria ka njohur humbje për gjopa e demshperblime të periudhëve të mëparshme në vlerën 351,621,765 Lekë. Mos paraqitja e shumave të parashikuara në pasqyrat financiare nuk është në përputhje me SNK 37, i cili kërkon përloganitjen e njohjen e provizioneve për risqet e parashikuara në lidhje me fakte dhe ngjarje ekonomike të ndryshme, duke përfshirë dhe ato ligjore. Gjithashtu, shoqëria ka marrë një njoftim detyrim nga autoriteti tatimor për vlerën prej 930,501,960 Lekë, e cila nuk është paraqitur në pasqyrat financiare të periudhës 2017. Për shkak të mungesës së informacionit, ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim mund të ketë qenë i nevojshëm në lidhje me provizionet për rreziqe dhe shpenzime si dhe efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit neto.

7. Në shënimin 17.7, në pasqyrën e pozicionit financiar, paraqiten 'Kunderparti jashtë përdorimit', në vlerën 240,098,860 leke në datën 31 Dhjetor 2017 dhe 2016. Këto balanca shfaqen si kundervlere e AAM, të cilat nuk disponohen me nga shoqëria apo janë jashtë përdorimit. Në këto rrethana shoqëria duhet të zbatojë kërkesat e SNK 16.

8. Standardi Nderkombëtar i Kontabilitetit 12 "Tatimi mbi të ardhurat" kërkon që Shoqëria të njohë tatime të shtyra, për diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuara dhe bazës tatimore. Shoqëria nuk ka llogaritur tatimin e shtyrë. Për sa më sipër, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që kjo përloganitje do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërisë në 31 Dhjetor 2017 dhe 2016.

9. Në shënimin 24, 'Primet e lidhura me kapitalin' janë paraqitur me vlerën negative prej -147,190,368 lekë në datën 31 Dhjetor 2017 dhe 2016. Nga dokumentacioni që na u vënë në dispozicion, këto vlera nuk janë prime të lidhura me kapitalin. Me gjithë procedurat e tjera alternative të kryera për të verifikuar saktësinë e këtyre vlerave të paraqitura si prime të kapitalit, ne nuk ishim në gjendje të krijojmë siguri të arsyeshme për vlerën e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë. Si rrjedhim, ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim mund të ketë qenë i nevojshëm në lidhje me primet e lidhura me kapitalin, sic paraqiten në pasqyrat financiare në datën 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 dhe efektet që rregullimet mund të kishin në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit neto.

Applikanti: Kristina Koka

10. Në shënimet për pasqyrat financiare Shoqëria nuk ka paraqitur shënimet për instrumentat financiarë në përputhje me SNRF 7, shënimet për palët e lidhura në përputhje me SNK 24 dhe shënimet për aktivet dhe detyrimet e kushëzuarra në përputhje me SNK 37.

*[Handwritten signatures and initials]*

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi pëmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-te, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke dhënë informacione shpjeguese për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Organet e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

*Applikant: [Signature]*  
*[Signature]*

*[Signatures]*

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personal e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

3 Shtator 2018

Apikanti: Kristina Jeko

*Kristina Jeko*

#### AUDITUESIT LIGJOR



Arqife Miftaku



Njazi LAZE

NJAZI LAZE  
EKSPERT KONTABEL  
AUTORIZUAR

Kristina Ndini  
E.K.R Lq. Nr.88

Kristina Ndini

Sokol Toska



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) - Aktivet

A K T I V E T		Shenimet	Viti ushtrimor 31.12.2017	Viti ushtrimor 31.12.2016
<b>Aktivët Afatshkurtra</b>				
<b>Aktivët monetarë</b>		1	249,412,646	23,557,466
1	Banika		249,256,414	23,208,402
2	Arka		156,232	349,064
<b>Investime</b>		2	0	0
1	Në tituj pronësie të njësisë ekonomike brenda grupit	2.1		
2	Aksionet e vota	2.2		
3	Të tjera Financiare	2.3		
<b>Të drejta të arkëtueshme</b>		3	21,078,335,490	20,986,028,799
1	Nga aktiviteti i shrytëzimit	3.1	16,232,705,925	15,831,502,434
2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit	3.2		
3	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	3.3		
4	Të tjera	3.4	4,845,629,565	5,154,526,366
5	Kapital i nënshkruar i papaguar	3.5		
<b>Inventarët</b>		4	2,978,209,024	4,148,231,610
1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	4.1	305,377,568	259,435,664
2	Prodhime në proces dhe gysëmprodukte	4.2	43,001,862	35,760,001
3	Produkte të gatshme	4.3	954,590,414	2,249,402,243
4	Mallra	4.4	1,675,239,180	1,603,633,702
5	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmën)	4.5		
6	AAGJM të mbajtura për shitje	4.6		
7	Parapagime për inventar	4.7		
<b>Shpenzime të shtyra</b>		5	0	
<b>Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara</b>		6		
<b>TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA</b>			24,305,967,160	25,157,817,875
<b>Aktivët Afatgjatë</b>				
<b>Aktive financiare</b>		7	0	0
1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	7.1		
2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit	7.2		
3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.3		
4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.4		
5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjatë	7.5		
6	Tituj të tjerë të huadhënies	7.6		
<b>Aktivët materiale</b>		8	46,358,257,688	46,621,285,159
1	Toka dhe ndërtesa	8.1	16,584,461,578	16,676,110,182
2	Impante dhe makineri	8.2	29,029,744,875	29,035,046,113
3	Të tjera instalime dhe pajisje	8.3	744,051,235	910,128,864
4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	8.4		
<b>Aktivët biologjike</b>		9	120,833	120,833
<b>Aktive jo materiale:</b>		10	44,821,429	30,145,428
1	Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngashme	10.1		
2	Emri i Mirë	10.2		
3	Parapagime për AAJM	10.3	44,821,429	30,145,428
<b>TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA</b>			46,403,199,950	46,651,551,420
<b>AKTIVE TOTALE</b>			70,709,157,110	71,809,369,295



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci) – Detyrimet dhe Kapitali

DETYRIMET DHE KAPITALI		Shenimet	Viti ushtrimor 31.12.2017	Viti ushtrimor 31.12.2016
<b>Detyrime afatshkurtra:</b>		13	796,654,421	1,223,232,315
1	Titujt e huamarrjes	13.1		
2	Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	13.2		
3	Arkëtime në avancë për porosi	13.3		
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13.4	575,167,201	1,001,931,490
5	Dëftesa të pagueshme	13.5		
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	13.6		
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	13.7		
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore	13.8	131,586,035	113,699,455
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	13.9	89,901,185	107,601,370
10	Të tjera të pagueshme	13.10		
<b>Grante</b>		15	68,372,842	71,730,982
<b>Totali i Detyrimeve afatshkurtera</b>			865,027,263	1,294,963,297
<b>Detyrime afatgjata:</b>		17	11,501,201,060	11,627,330,992
1	Titujt e huamarrjes	17.1	149,609,676	138,989,209
2	Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	17.2		
3	Arkëtime në avancë për porosi	17.3		
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	17.4	8,228,525,600	8,259,275,999
5	Dëftesa të pagueshme	17.5		
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	17.6		
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike/parti j perd.	17.7	240,098,860	240,098,860
8	Të tjera të pagueshme	17.8	2,882,966,924	2,988,966,924
<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>		18		
<b>Të ardhura të shtyra</b>		19		
<b>Provizione:</b>		20	30,000,000	30,000,000
1	Provizione për pensionet	20.1		
2	Provizione të tjera	20.2	30,000,000	30,000,000
<b>Detyrime tatimore të shtyra</b>		21		
<b>Totali i Detyrimeve afatgjata</b>			11,531,201,060	11,657,330,992
<b>DETYRIMET TOTALE</b>			12,396,228,323	12,952,294,289
1	Kapitali dhe Rezervat			
2	Kapitali i Nënshkruar	23	14,701,929,000	14,701,929,000
3	Primi i lidhur me kapitalin	24	-147,190,368	-147,190,368
4	Rezerva rindërsim	25	43,062,377,057	43,201,518,459
5	Rezerva ligjore	26.1	538,768,533	538,768,533
6	Rezerva statutove			
7	Rezerva të tjera	26.3	909,718,506	909,718,506
8	Filmi i pasqëndarë	27	-347,669,124	-1,880,101,372
9	Fitim / Humbja e Viti	28	-406,004,815	1,532,432,248
<b>Totali i Kapitalit</b>			58,312,928,787	58,857,075,006
<b>TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>			70,709,157,110	71,809,369,295

Aplikanti: Enxheta  
Jaka

*[Signature]*

Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithpërfshirëse

Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	Viti ushtrimor 31.12.2017	Viti ushtrimor 31.12.2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	29	6,676,764,749	2,254,945,978
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	30	-2,130,149,006	1,285,401,536
Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	31	12,192,874	100,941,447
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	32	213,994,228	1,740,289,776
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33	-1,151,464,277	-931,306,279
1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33.1	-1,151,464,277	-931,306,279
2 Të tjera shpenzime	33.2		
Shpenzime të personelit	34	-1,976,217,278	-1,485,508,632
1 Paga dhe shpërblime	34.1	-1,770,570,055	-1,313,781,473
2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	34.2	-205,647,223	-171,727,159
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36	-312,196,618	-484,898,670
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	37	-1,692,385,843	-1,003,448,581
Të ardhura të tjera	38	171,221	56,015,673
1 Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	38.1		
2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata	38.2		
3 Intereza të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme	38.3	171,221	56,015,673
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	39		
Shpenzime financiare	40	-15,174,096	
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	40.1		
Shpenzime të tjera financiare	40.2	-15,174,096	
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	41		
Fitimi/Humbja para tatimit	42	-374,464,046	1,532,432,248
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	43	-30,540,770	
1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	43.1	-30,540,770	
2 Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë	43.2		
3 Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve	43.3		
Fitimi/Humbja e vitit	44	-405,004,815	1,532,432,248
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		0	0
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin	45	0	0
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	46	-405,004,815	1,532,432,248

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

Përshkrimi	Kapitali i rindërtuar	Primi i tërthur në kapitalin	Rrezerva Rindërtimi	Rrezerva Lëgjore	Rrezerva Statutore	Rrezerva të tjera	Firmat e Pashpërndara	Firmat / Humbja e vlerë	Totali	Totali	Totali
pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	13,360,997	14,126,414	29,537,325	307,701		2,840,786	-3,813,606	1,176			56,360,793
Jakti i ndryshimeve në pajtimet kontabël											0
pozicioni financiar i rindërtuar më 1 janar 2015	13,360,997	14,126,414	29,537,325	307,701		2,840,786	-3,813,606	1,176			56,360,793
Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											
firmat / Humbja e vlerë											0
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											0
Totali i te ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											0
transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njëzëra direkt në kapital:											0
ndryshimi i kapitalit të rindërtuar	1,340,932	-14,273,696	13,664,194	231,067		-1,911,067	1,933,505	1,531,256			2,486,262
ndryshimi të paguar											0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											0
pozicioni financiar i rindërtuar më 31 dhjetor 2016	14,701,929	-147,191	43,201,519	538,768	0	989,719	-1,880,101	1,532,432	0	0	58,857,075
Jakti i ndryshimeve në pajtimet kontabël											0
pozicioni financiar i rindërtuar më 1 janar 2017	14,701,929	-147,191	43,201,519	538,768	0	989,719	-1,880,101	1,532,432	0	0	58,857,075
Totali i te ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:											0
firmat / Humbja e vlerë								-405,004			-405,004
firmat / firmat							1,532,431	-1,532,431			0
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:											0
Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:											0
transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njëzëra direkt në kapital:											0
ndryshimi i kapitalit të rindërtuar	0	0	-130,141	0		0					-130,141
ndryshimi të paguar											0
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											0
pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	14,701,929	-147,191	43,062,377	538,768	0	989,719	-347,669	-405,004	0	0	56,312,929

Aplikanti

Kristina Kola




## Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	Viti ushtrimor 31.12.2017	Viti ushtrimor 31.12.2016
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>			
Fitim / Humbja e vitit		-374,464,046	1,532,432,248
<b>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</b>			
Shpenzimet financiare jomonetare			
Shpenzimet për taksim mbi fitimin jomonetar			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		312,196,618	484,898,670
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzim taksim fitimi			
<b>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</b>			
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit			
Rritje/(rënie) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(92,306,691)	(1,376,343,696)
Rritje/(rënie) në inventarë		1,170,022,586	(1,200,729,541)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(573,952,546)	637,137,365
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit dhe të tjera		17,886,580	(12,208,091)
Të ardhura të shlyra		(2,497,785,582)	(1,792,491,648)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>(2,038,403,080)</b>	<b>(1,727,304,693)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		871,138,636	831,046,790
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera			
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		<b>871,138,636</b>	<b>831,046,790</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		0	1,340,932,000
Hua të arkëtuara		0	0
Primi i lidhur me kapitalin		0	(14,273,604,515)
Rezerva rivelesimi		1,393,290,846	13,897,697,872
Interes i paguar / arkëtuar		(171,221)	(56,015,673)
Pagese dividendi			
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		<b>1,393,119,625</b>	<b>909,009,684</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>		<b>225,855,181</b>	<b>12,751,781</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2017</b>		<b>23,557,466</b>	<b>10,805,685</b>
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare			
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017</b>		<b>249,412,646</b>	<b>23,557,466</b>

Drejtori i Drejtorisë Financiare

Zhaneta NDREKO




Aplikanti: Instanca  
Late



## Shenime shpjeguese për Pasqyrat Financiare

### 1. Informacione të përgjithshme

Albpetrol sha (Shoqëria) është një shoqëri anonime shqiptare që ka për objekt kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure në përputhje me Ligjin Nr-7746, datë 28.08.1993 për Prodhim, Zhvillim, Trajtim, Transport, Magazinim dhe Shitjen e naftës Brut, Gazit dhe Rerave Bituminoze brenda dhe jashtë REPUBLIKES SE SHQIPERISE si dhe çdo operacion tjetër tregtar apo shërbime që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë. Shoqëria, brenda hapësirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi kryen çdo operacion projektues - preventivues, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërësisht me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm e të ligdhshëm në përputhje me interesat e saj. Realizimi i objektivit të veprimtarisë të shoqërisë bëhet nëpërmjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftëmbajtëse dhe ato gazmbajtëse të vendit, kërkimeve të reja, zhvillimit të blloqeve në administrim si dhe shfrytëzimit të rërave bituminoze, furnizimit me energji elektrike të klienteve të kualifikuar, tregtimin e energjisë elektrike, transmetimin e gazit natyror, shpërndarjen e gazit natyror, leje mjedisore për veprimtari me diktim në mjedis për vendburimet e naftës në zonat Kucove, Patos-Marinez (Drize +Goran), Baltsh Hekal, Amonice Gorisht, për vendburimet e gazit në zonën Divjak - Lushnje, Frakull-Fier, Povlec Fier, Finiq -Sarand, njëti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit, vendburimi i rërës bituminoze Kasnic-Fier, Uzina Mekanike Kucove dhe Uzina Metanike Patos.

Shoqëria është themeluar në bazë të Vendimit të Gjykatës Nr. 21158 datë 8 Prill 1999 sipas regjistrimit tregtar, bazuar në ligjin Nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 "Mbi shoqëritë tregtare". Selia e shoqërisë është në adresën Patos, Fier.

Kapitali i nënshkruar i saj është 14,701,929,000 leke, i ndarë në 14,701,929 aksione me vlerë nominale 1,000 leke secili. Kapitali i paguar është regjistruar në Leke.

Aksionet e Shoqërisë ALBPETROL Sha janë nën pronësinë e Shtetit Shqiptar të përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Drejtuessit e Shoqërisë janë si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Bordi i Drejtorëve

Këshilli Mbikëqyrës aktual i ALBPETROL sha përbëhet si më poshtë:

1.	Koli	BELE	Anëtar
2.	Enkelejda	PESHKEPIA	Anëtar
3.	Stefanaq	KOCOLLARI	Anëtar
4.	Andrus	OLLDASHI	Anëtar
5.	Illa	GJERMANI	Anëtar
6.	Genjani	KERI	Anëtar

Administratori i shoqërisë: Endri PUKA

Me vendim nr 1, datë 25/01/2018 të Keshillit Mbikqyrës të Albpetrol sha, është linqar nga detyra e administratorit Z Endri Puka, dhe është emëruar në detyrën e administratorit të Shoqërisë Albpetrol sha, Z. Kasriot Bejtaj.

Veprimtaria e përditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, të cilit, i përkasin të gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tjerët.

Numri i punonjëseve më 31 dhjetor 2017 është 2.277 punonjës (2016: 1.867 punonjës).

*Aplikimti + Z. Kasriot Bejtaj*  
*Kasriot*  
*Kasriot*

Ne përputhje me veprimtarinë dhe organizimin administrativ, shoqëria ka organizuar kontabilitetin në disa njësi vartëse ose qendra, të cilat përgatisin secila Pasqyra Financiare me vetë dhe nxjerrin rezultat të veçantë. Në Qendër, shoqëria përgatit Pasqyrën Financiare përmbljedhëse të bilanceve kontabel të njësisve të saj. Kontabiliteti në Qendër është i informatizuar, ndërsa në njësitë vartëse mbahet në mënyrë të përzier, manuale dhe të informatizuar.

Emertimi i njësisve vartëse është si më poshtë:

1-QPN Patos	(Qendra Prodhimit të Naftës Patos)
2-QPN Kucove	(Qendra Prodhimit të Naftës Kucove)
3-QPN Balish	(Qendra Prodhimit të Naftës Balish)
4-QASHNG	(Qendra Administrimit të Shitjes Naftë e Gaz)
5-QAR	(Qendra Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës)
6-QSHGJ	(Qendra e Shërbimeve Gjeofizike)
7-QFSHE	(Qendra e Furnizimit dhe Shërbimeve Elektrike)
8-QEMNG	(Qendra Emergjencës Mjedisit Naftës e Gazit)
9-QFMT	(Qendra Furnizimit Materialeve Teknike)
10-QT Patos	(Qendra e Transportit)
11-QMN Kucove	(Qendra Mekanike Naftës Kucove)
12-QPN Gorisht	(Qendra Prodhimit Naftës Gorisht)
13-Administrata Albpetrol	

#### Auditi i brendshëm

Në shoqërinë Albpetrol sh.a. ekzistojnë procedura dhe programe që synojnë të ndikojnë në mbrojtjen e pasurisë, ruajtjen e interesave të pronarit të vetëm, zbulimin e anomalive dhe parregullsisive, saktësimin e informacioneve ekonomiko-financiare, etj.

Për ndjekjen e kësaj pune vepron Departamenti i Auditit të Brendshëm, i cili ka varësi të plotë nga Këshilli Mbikqyres. Ky i fundit orienton, harton dhe miraton programet dhe planet e kontrollit për Departamentin e Auditit të Brendshëm, i cili është pjesë e kontrollit të përgjithshëm shtetëror dhe ushtron veprimtarinë e tij konform ligjeve, vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe metodikave të hartuara nga strukturat e ngarkuara nga Këshilli i Ministrave për këtë qëllim. Auditit i brendshëm nuk është në përbërjen e strukturave të tjera të shoqërisë ALBPETROL SHA.

Kështu gjatë vitit 2017 Departamenti i Auditit të Brendshëm ka kryer kontrole të plota ekonomike dhe financiare sipas programit të hartuar dhe kanë nxjerrë rezultatet e tyre.

Bazuar në strategjinë e zhvillimit të shoqërisë, prioritet i veçantë i është dhënë thirrjes së investimeve të huaja. Gjatë vitit 2017 ka vazhduar bashkëpunimin i shumë kompanive të huaja me eksperiencë në zhvillimin e vendburimeve të naftës dhe të gazit për kërkim-zbulimin e zhvillimin e vendburimeve që administrojnë Albpetrol, në zbatim të Marrëveshjeve Hidrokarbure me kompanitë "Bankers Petroleum Albania" Ltd., "Sherwood", "Transoil Group" dhe "Phoenix", nga momenti i fillimit të marrëveshjeve dhe deri më 31.12.2017.

Aplikanti: Kristina Keda



Tabela e mëposhme jep numrin e puseve sipas çdo kompanie që vepron në bazë të Marrëveshjes së Hidrokarbureve:

Nr	Emertimi Kompanise	Nr i puseve të dorëzuar deri në fund të vitit 2016	Nr i puseve të dorëzuar në vitin 2017	Nr i puseve të dorëzuar deri në fund të vitit 2017
1	Bankers Petroleum	1135	0	1135
2	Transatlantic Ltd	391	0	391
	a) Vendburimi CA-MO	69	0	69
	b) Vendburimi BA-HE	23	0	23
	c) Vendburimi GO-KO	295	0	295
	d) Vendburimi Delvine	4	0	4
3	Sherwood	94		94
4	Transoil Ltd	235	0	235
5	Phoenix Petroleum	490	0	490
	Gjithësej	2736		2736

Gjatë vitit 2017, si rezultat i ndryshimit të marrëveshjeve Hidrokarbure, janë marrë nga kontraktori TransAtlantic Albania Ltd, vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, si dhe nga kontraktori Phoenix Petroleum, vendburimi Amonice, vendburime, që nga perioda e marrjes në dorezim deri në fund të vitit 2017, u administruan nga shoqëria Albpetrol sha, duke u përfshirë në treguesit e program zhvillimit të vitit 2017.

Ky fakt ndikoi edhe në mirënjohjen e disa zerave të shpenzimeve, në ndryshim nga viti 2016.

Prodhimi i marrë nga këto vendburime që nga data e marrjes në dorezim, është i reflektuar në bilancet respektive të qendrave të shoqërisë ku këto vendburime u bashkëngjiten.

Datat e marrjes në dorezim të vendburimeve paraqiten si më poshtë:

1-Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Gorisht-Kocul është mbyllur me datë 25.01.2017.

Mbyllja e kësaj marrëveshjeje u bë bazuar në shkresën e MEI me nr. 431/1 prot., datë 24.01.2017, si dhe në shkresën e Albpetrol sh.a nr 7864 prot., datë 02.12.2016, për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurave të marrjes në dorezim të vb. Gorisht-Kocul.

2-Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Cakran-Mollaj është mbyllur me datë 01.02.2017.

Mbyllja e kësaj marrëveshjeje u bë bazuar në shkresën e MEI me nr. 431/1 prot., datë 24.01.2017, si dhe në shkresën e Albpetrol sh.a, me nr. 7865 prot. datë 02.12.2016, për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurave të marrjes në dorezim të vendburimit Cakran-Mollaj.

3-Marrëveshja Hidrokarbure për vendburimin Amonice është mbyllur me datë 13.03.2017.

Mbyllja e kësaj marrëveshjeje u bë bazuar në shkresën e MEI me nr. 936/4 prot., datë 09.03.2017, si dhe në shkresën e Albpetrol sh.a, me nr. 757/1 prot. datë 10.03.2017, për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurave të marrjes në dorezim të vendburimit Amonice.

Aplikuarti:

Kristina

Jole  
ka

## 2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

### 2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2017 ose pas kësaj date:

- Përmirësimet vjetore të SNRF (Cikli 2014 - 2016): SNRF 12 Shpalosjen e interesave në njësi të tjera
- SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat (Amendim – Njohja e taksës së shtyrë si asset për humbje të përcaktuara)
- SNK 7 Pasqyra e Flukseve Monetare (Shpalosjen e Amendimeve fillestare)

Nuk ka patur standarde apo interpretime të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2017 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

### 2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël të cilat behën efektive në periudhat e ardhshme kontabël dhe që kompania nuk ka vendosur ti përvetësojë më shpejt. Më të rëndësishmet janë:

- SNRF 9 Blerësit e instrumentave financiar (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date)
- SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me blerësit (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date), dhe
- SNRF 16 Qiratë (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2019 ose pas kësaj date)
- Të tjera

Kompania nuk parashikon standarde të tjera të publikuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël, që nuk janë në përdorim, të kenë ndikim material në pasqyrat financiare.

- KIRFN 22 Përkthimin e Monedhave të huaja dhe Vlerësimin në Avancë (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Amendime të klasifikimeve të SNRF 2 dhe Matja e Transaksioneve me Pagesë Aksionesh (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Amendime të SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiar me IFRS 4 Kontratat e Sigurimit (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Amendime të SNA 40: Transferrat e Pasurive Investuese (në fuqi më 1 Janar 2018)
- Përmirësimet vjetore të Standardeve SNRF, cikli 2014 – 2016, që ndeshet me çështjet e SNRF 1 për herë të parë
- Adopsioni dhe SNA 28 Investime në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (në fuqi më 1 Janar 2018)
- KIRFN 23 Paqartësi mbi Pozicionin e Taksës mbi të Ardhurat (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- Amendime të SNRF 9 Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- Amendime të SNA 28: Interesat Afatgjatë në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (hyn në fuqi më 1 Janar 2021)

## 3. Bazat e përgatitjes

### Doktarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe parimet e ligjit Nr 9228, dt.29/04/2004 "Mbi Kontabilitetin" dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të aprovuara dhe të shpallura për zbatim nga Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK).

### Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimin e të drejtave të konstatuara.

### Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili mërr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare përgatiten në Lek, e cila është monedha funksionale dhe e paratijtes të pasqyrave financiare të Shoqërisë.

Aplikanti: Kristina  
Ido



### Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimëve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe përflogaritje, të cilat kanë efekte në aplikimin e politikave kontabel dhe në vlerat e aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe përflogaritjet janë bazuar në përvijën e mëparshme dhe në faktore të tjera, të cilat drejtimi i Shoqërisë i konsideron të arsyeshëm sipas rrethanave. Rezultatet e tyre përbejnë bazën për vlerësimin e vlerës për t'u mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për të cilat nuk janë dhënë informacione shpjeguese në burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet që ishin bërë.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Efektet që rrjedhin nga rishikimi i vlerësimeve kontabel njihen në periodën në të cilën vlerësimi është riparë dhe në çdo periudhë të ardhshme.

#### *Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme*

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuarat të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në regjistrimin, vlerësimin e afësisë-paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### *Provizionet*

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### *Zhvlerësimi i inventarëve*

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabel neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

Aplikanti: Kristina  
Kata  
be

#### 4. Pëmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

##### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekte të një riziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Fluksel monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shlyrëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivite të tjera të cilat nuk janë aktivite investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivite financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

##### Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotësojnë kushtet në njohje, regjistrohen në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji, mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si me poshtë zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit, zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin.

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR/Lek	132.95	135.23
USD/Lek	111.10	128.17

##### Inventarët

Inventari është paraqitur me vlerën me të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i perfoliguar gjatë rrjedhës normale të biznesit pa koston e perfoliguar të perfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kosto është llogaritur si vijon:

Lendet e para	- Me koston e blerjes dhe inventari i imët kosto blerje minus konsumin e llogaritur.
Prodhime në proces	- Me kosto në bazë të metodës së mesatares së ponderuar
Produkt i gatshëm	- Me kosto në bazë të metodës së mesatares së ponderuar

Aplikanti:  
Kristine Jaka  
ke

## Aktive afatgjata materiale

### Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me vlerën e drejtë, në përputhje me rivlerësimet e kryera gjatë viteve. Në vitin 2005, bazuar në vendimin e Ministrisë së Ekonomisë nr 4152 prot. date 12.07.2005, "Mbi rivlerësimin e aseteve të shoqërive strategjike", si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave "Për autorizimin e shoqërive tregtare me kapital shtetëror të sektorit strategjik, të rivlerësojnë pasurinë", u krye rivlerësimi i aseteve të kompanisë Albpetrol sha. Gjithashtu, në vitin 2009, në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 1620, date 26.11.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve", që ndodhen në të gjitha bashkitë e disa komuna, me shkresë nr 6616 prot. date 21.08.2009, të Ministrisë së Ekonomisë Tregësisë dhe Energjitikës, u krye rivlerësimi i zërit "Toka", në grupin e AAM të Shoqërisë Albpetrol sha.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përfundimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Kostot përfshijnë shpenzime që janë kryer drejtpërdrejt për blerjen e aktivit. Kostot e aktiveve të ndërtuara nga vete shoqëria, përfshijnë kostot e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet direkt me vënien e aktivit në kushte pune, si dhe kostot e çmontimit të zhvendosjes dhe të magazinimit të tyre në vendndodhjen përkatëse. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Filimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar të ardhurat monetare nga shitja me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale, dhe njihen neto brenda zërit "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivet e rivlerësuar shihen, sasië e përfshira në rezervën së rivlerësimit transferohen në fitimin e mbajtur, ndërsa mungesa e rivlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimit të periudhës.

### Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve me baze lineare për ndërtesat dhe lidhjet teknologjike, pusët, tubacione, mbi bazën e jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale dhe me metodën zbritëse për makinat dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës dhe kompjuterike, dhe aktivet e tjera me një normë amortizimi siç shpjegohet më poshtë. Toka dhe punimet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit me të cilat punon shoqëria:

	2017	2016
<u>Baze lineare</u>		
• Ndërtesa	1.5%	1.5%
• Lidhjet teknologjike, pusët, tubacione	1.5%	1.5%
<u>Metoda zbritëse</u>		
• Makineri dhe pajisje	2.5%	2.5%
• Pajisje, e të tjera	3 %	3 %

### Çregjistrimi

Një zëri i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerja e tij jashtë përdorimit.

Filimet dhe humbjet në rastin e nxjerjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerjen e rezultatit operativ të vitit.

Apliment!  
Kristina Jaka

### Aktive afatgjata jomateriale

#### Njotja dhe matja

Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përtohen nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

#### Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shkojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si lirim/humbje kur ndodhin.

#### Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

### Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përfshijnë investimet në aksione, kërkesa të arketueshme nga klientet, të tjera kërkesa të arketueshme, mjete monetare dhe të ngjashme, kredi të dhena dhe të marra, llogarë të pagueshme të tregtimit.

Instrumentat financiarë jo-derivative janë njohur fillimisht me vlerën e drejte plus të gjitha kostot e transaksionit që i përkasin në mënyrë të drejtëdrejte.

#### Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare

Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare përfshijnë gjendjet e llogarive dhe depozitat që mund të tërhiqen menjëherë. Ekuivalente të mjeteve monetare përfshijnë gjithashtu depozita afatshkurtra me pak se tre muaj.

#### Investimet të pranzuara me vlerën e drejte nepermjet pasqyre se të ardhurave

Një instrument financiar është klasifikuar si i vlerësuar me vlerën e drejte nepermjet pasqyre se të ardhurave nëse është i mbajtur për t'u shitur. Instrumentat financiarë përcaktohen si të vlerësuar me vlerën e drejte nepermjet pasqyre se të ardhurave nëse Shoqëria i menaxhon këto investime dhe merri vendimet për blerjen dhe shitjen e tyre bazuar në vlerën e drejte. Pas njëjtes fillëtare, koston e lidhura drejtpërdrejt me transaksionin njihen si të ardhura dhe shpenzime kur ato ndodhin. Këto instrumenta financiarë vlerësohen me vlerën e drejte dhe ndryshimet përkatëse njihen si të ardhura ose shpenzime të periudhës ushtrimore.

#### Te tjera

Instrumentat e tjerë financiarë jo-derivative vlerësohen me koston të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjen nga rrvlerësimi, si me poshtë:

Llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjerat janë paraqitur me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Pasqyrat financiare përfshijnë provizione speciale në lidhje me llogaritë e arketueshme të dyshimta, të cilat sipas opinionit të organeve drejtuese të Shoqërisë, reflektojnë në mënyrë të njallueshme humbjen e përfshirë në ato llogari, mbledhja e të cilave është e dyshimtë.

Përcaktimi i njallueshmërisë së provizionit nga ana e organeve drejtuese është bazuar, ndër të tjerave edhe në vlerësimin e rrezikshmërisë, duke konsideruar informacionin në dispozicion për bilancin e debitorit, volumin e aktivitetit të tyre tregtar dhe garancive të marra prej tyre.

Llogaritë e arketueshme afatgjata janë deklaruar me vlerën e tyre aktuale.

#### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Aplikanti:  
Kristina Joka  


Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabel.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në fluksin e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së ribetur dhe vlerës aktuale të fluksive të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtëmi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

**Përfitimet e punonjësve***Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që u sigurojnë përfitimet pensioni punonjësve pas daljes në pension. Kontributet e Shoqërisë në planin e përfitimt të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ndodhin.

**Provizionet**

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose të lartbortë) si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën dhe ka mundësi që do të nevojitet një fluks burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për të përbushur detyrimin dhe në këtë mënyrë mund të bëhet një përlogaritje e besueshme e shumës së detyrimit. Në rast se efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke skontuar fluksin e pritshme të parasë me normën e uljes para tatimeve, e cila reflekton vlerën kohore të parasë në kushtet aktuale të tregut dhe, aty ku është e përshkueshme, normën e riskut të pasiveve specifike. Provizionet rishikohen në çdo datë bilanci dhe nëse nuk ka më mundësi për nevojën e një fluksi burimesh që përfshin përfitimet ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushëtzuara nuk njihen.

*Aplikanti:*

*Kristina*

*Joko*

**Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**Njohja e të ardhurave***Mallrat e shitur*

Të ardhurat nga shitja e naftës dhe gazit janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose të arkëtueshme, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rugës, dhe të tjera të ngjashme). Të ardhurat nga shitja e mallrave janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose për tu arkëtuar, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejtë të kompesimit të marrë, neto nga këtimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatet. E ardhura është ngjohur kur rreziqet dhe të drejtat mbi produktet i kalojnë në një pjesë të rëndësishme blyerësit, marrja e kompesimit është e mundshme, kostot e lidhura dhe këtimet e mundshme të mallrave mund të maten me besueshmëri dhe nuk ka me përshirje të vazhdueshme të drejtimit të Shoqërisë me këto produkte.

*Të ardhurat nga qiraja*

Kosto fikse të qerazë për këto linja të lidhura shpenzohen në baze të metodës lineare mbi kushtet e qerazë. Shpenzimet e lidhura nga qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në baze të metodës lineare sipas kohëzgjatjes së qirasë.

*Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen atëherë kur ndodhin.

*Të ardhurat dhe shpenzimet financiare*

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe të ardhurat nga këmbimi valutor që njihen si fitime ose humbje. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazë mjedhëse, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga këmbimi valutor.

*Tatim Fitimi*

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhen nga tatimi aktual dhe ai i shtyre. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e bilancit kontabël, duke sjellë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve për raportin financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi. Diferencat e përkohshme nuk parashikohen për ngjarjet të ardhshme të aktiveve dhe pasiveve që nuk kanë asnjë ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshëm. Shuma e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit apo shlyerjes së shumës së akumuluar të aktiveve dhe pasiveve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit.

Një aktiv i detyrimit të shtyre njihet vetëm nëse ka të ngjarë që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, e ndaj të cilave aktiv mund të përdoret. Aktivët e tatimit të shtyre reduktohen deri në shkallën ku nuk është më e mundur që të realizohet përfitimi përkatës nga tatimi.

**Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Rëndësishmërit janë kryor për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

5. Shënime të tjera shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare

S 1 Mjete monetare (likuiditete në arke, banke)

Gjendjet e mjeteve monetare në banke dhe arke në fillim dhe në fund të ushtrimit janë si më poshtë:

S1 Aktivet monetare	1	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
Banka		249,256,414	23,208,402
Arka		156,232	349,064
<b>Totali</b>		<b>249,412,646</b>	<b>23,557,466</b>

Gjendjet e llogarive të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave në fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhe të huaj janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e kombinimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë më 31/12/2017 dhe diferencat janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

S 3 Te drejta të arkëtueshme


S3	Të drejta të arkëtueshme-Nga aktiviteti i shfrytëzimit	3	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	3.1	17,776,930,662	17,382,101,610
	<i>Deri 1 vit</i>		985,948,299	973,835,492
	<i>Mbi 1 vit</i>		16,790,982,363	16,408,266,119
	<i>Zhvlerësimi kërkesave të arkëtueshme</i>		-1,544,224,737	-1,550,599,176
	<b>Totali</b>		<b>16,232,705,925</b>	<b>15,831,502,434</b>

Te drejta të arkëtueshme: paraqesin kërkesat e vlefshme ndaj debitoreve për shitjet e mallrave apo shërbimeve në datën e mbyljes së bilancit (shih pasqyrën analitike)

Zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme paraqet provizionet e krijuara për kërkesat e arkëtueshme. Diferenca 6,374,339 lekë është miratuar provizionesh për vlerën neto të AAM të njëjta jashtë përdorimit në Qendren e Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës (QAR), të miratuara me vendim të Keshillit Mbikqytës nr 42, dt 15/05/2017, miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë me shkresën nr 3973/1, dt 22.05.2017, për të cilat është llogaritur provizion në vitin 2014.

Te drejta të arkëtueshme për vitin 2017, mund të detajohen më tej si më poshtë:

	Te drejta të arkëtueshme nga aktiviteti shfrytëzimit	3.1	31/12/2017 Deri 1 vit	31/12/2017 Mbi 1 vit
1	<i>Ammo shtu</i>		0	11,682,491,639
2	<i>Shtetërore</i>		13,086,290	331,946,220
3	<i>Private</i>		972,862,009	4,776,544,504
			<b>985,948,299</b>	<b>16,790,982,363</b>

23  
Aplimentuar: Kristina Jato  


## S 3.4 Te tjera te drejta te arkëtueshme ne fillim dhe ne fund te ushtrimit paraqiten:

S3.4	Të drejta të arkëtueshme-Të tjera	3.4	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Aktiva te tjera</i>		1,323,389,452	1,294,229,206
	<i>Den 1 vit</i>		100,113,772	76,223,768
	<i>Mbi 1 vit</i>		1,223,275,680	1,218,005,438
	<i>TVSH</i>		342,882,649	57,143,595
	<i>Talim ne burim</i>		0	134,280
	<i>Talim fillim</i>		171,188,384	150,358,553
	<i>Akzoza</i>		74,836,091	74,836,091
	<i>TAP</i>		3,013,243	2,981,268
	<i>Detyrim per sigurime shoqerore mbi 1 vit</i>		116,463,402	116,293,922
	<i>Te drejta nga kontraktoret neto</i>		2,497,785,582	3,348,670,119
	<i>Hua te dhena</i>		316,070,762	109,879,332
	<b>Totali</b>		<b>4,845,629,565</b>	<b>5,154,526,366</b>

Ne detyrimet talimore paraqitet leprica debitore e tyre. Per zerin TVSH dhe Talim fillim jane bere parapagime gjate vitit 2017.

Ne aktive te tjera, shuma 2,497,785,582 leke, paraqet te drejtat e shoqerise, qe rrjedhin nga detyrimet kontraktuale te te treqeve konform parashikimit te termave te kontratave hidrokarbure, te lidhura midis Shoqerise Albpetroi sha dhe kontraktoreve, qe duhet te ishin marre ne dorezim, por qe nuk jane levruar fizikisht ne depozitat e Shoqerise Albpetroi sha.

Gjate vitit 2017, sasia e levruar nga kontraktoret sipas termave te marreveshtjes hidrokarbure, ka qene me e larte, gjë qe ka pakësuar gjendjen e produktit pranë kontraktoreve.

Hua te dhena paraqet transferime fondesh te kryera nga Albpetroi ne favor te kompanive te tjera publike nepermjet kontratave te huave.

## S 4 Inventaret

Inventarot ne fillim dhe ne fund te ushtrimit, paraqiten si me poshte.

S 4	Inventarët-Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	<i>a-Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	4.1	442,865,037	397,102,038
	<i>b-Zhvleresimi i materialeve</i>		-137,487,469	-137,666,374
	<b>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</b>		<b>305,377,568</b>	<b>259,435,664</b>
2	<i>Prodhime në proces dhe gysëmprodukte</i>	4.2	43,001,862	35,760,001
3	<i>Produkte të gatshme</i>	4.3	954,590,414	2,249,402,243
4	<i>Mallra</i>	4.4	1,675,239,180	1,603,633,702
	<b>Totali</b>		<b>2,987,209,024</b>	<b>4,148,231,610</b>

Inventarët pasqyrohen ne menyre analitike ne cdo rresi. Zhvleresimi i materialeve paraqet provizion te krijuar per mallrat stoqe. Diferenca prej 178,005 leke, eshte zhvleresim i inventareve te OPN Palos, si rezultat i vleresimit te stokut gjendje ne magazine ne momentin e perdorimit per nevoja te aktivitetit te qendres perkatese.

Aplikanti: *Fristno Joka*  
*[Signature]*



S 8 Aktive Materiale

	Toka	Ndertesa	Impjante dhe makineri	Pajisje informatike	Te tjera ne shfrytezim	TOTALI
	Leke	Leke	Leke	Leke	Leke	Leke
<b>VLERA BRUTO AAM</b>						
Gjendja me 1 Janar 2016	14,956,209,775	2,389,640,626	36,075,585,745	107,942,320	1,234,051,753	54,763,430,219
Shtesa gjate vitit	183,757,500	18,598,588	490,839,710	10,530,356	175,448,622	879,174,776
Pakesime gjate vitit	323,327,975	29,393,084	1,102,739,767	11,090,564	452,967,498	1,919,518,888
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	14,816,639,300	2,378,846,130	35,463,685,688	107,382,112	956,532,877	53,723,086,107
<b>AMORTIZIMI</b>						
Gjendja me 1 Janar 2016	0	493,711,604	6,207,480,297	29,996,019	119,705,434	6,850,893,354
Shtesa gjate vitit	0	31,731,716	641,642,770	2,356,980	5,745,211	681,476,677
Pakesime gjate vitit	0	6,068,072	420,483,492	2,024,673	1,992,846	430,569,083
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	0	519,375,248	6,428,639,575	30,328,326	123,457,799	7,101,800,948
<b>VLERA NETO AAM</b>						
Gjendja neto me 1 Janar 2016	14,956,209,775	1,895,929,022	29,868,105,448	77,946,301	1,114,346,319	47,912,536,865
Gjendja neto me 31 Dhjetor 2016	14,816,639,300	1,859,470,882	29,035,046,113	77,053,786	833,075,078	46,621,285,159
<b>VLERA BRUTO AAM</b>						
Gjendja me 1 Janar 2017	14,816,639,300	2,378,846,130	35,463,685,688	107,382,112	956,532,877	53,723,086,107
Shtesa gjate vitit	1,284,327,506	208,433,164	18,843,851,209	20,523,041	260,483,786	20,617,618,706
Pakesime gjate vitit	1,284,327,506	278,095,196	18,765,341,681	4,831,636	442,247,281	20,774,843,300
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	14,816,639,300	2,309,184,098	35,542,195,216	123,073,517	774,769,382	53,565,861,513
<b>AMORTIZIMI</b>						
Gjendja me 1 Janar 2017	0	519,375,248	6,428,639,575	30,328,326	123,457,799	7,101,800,948
Shtesa gjate vitit	0	56,673,686	2,540,750,219	3,292,864	471,376	2,601,188,145
Pakesime gjate vitit	0	34,687,114	2,456,939,453	887,862	2,870,839	2,495,385,268
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	0	541,361,820	6,512,450,341	32,733,328	121,058,336	7,207,603,825
<b>VLERA NETO AAM</b>						
Gjendja neto me 1 Janar 2017	14,816,639,300	1,859,470,882	29,035,046,113	77,053,786	833,075,078	46,621,285,159
Gjendja neto me 31 Dhjetor 2017	14,816,639,300	1,767,822,278	29,029,744,875	90,340,189	653,711,046	46,358,257,688

AAM janë njohur ne kontabilitet me koston e blejes se tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike te saj kontabilitet modelin e koston ku çdo element i AAM paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar. Shoqëria nuk ka akumuluar as një humbje nga zhvlerësimi. Normal e amortizimi te zbatuara janë ato te përcaktuara ne vendimin nr.24,dt.30/04/2007 te Keshillit Mbledhës dhe jo normal fiskale te përcaktuara ne ligjin nr.8438,dt.28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat".

Ne zbatim te Urdhërit te Ministrisë te Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipërmarjes nr.1461,dt.20/02/2015,eshite kryer rrvleresimi i Aktiveve Atatgjata Materiale per shoqerine Albpetroi sha. Efektet e rrvleresimit te AAM nuk jane pasqyruar ne PF te ketij viti, pasi raporti i rrvleresimit te AAM , u miratua ne mbledhjen e Keshillit Mbledhës te Albpetroi sha ne date 29.08.2018.

25 Aplikanti: Kristino  
Joka

Normat e amortizimit janë si më poshtë:

	2017	2016
<u>Baze lineare</u>		
• Ndërtesa	1.5%	1.5%
• Idhjet teknologjike, puset, tubacione	1.5%	1.5%
<u>Metoda zbritëse</u>		
• Makineri dhe pajisje	2.5%	2.5%
• Pajisje, e të tjera	3 %	3 %

#### S 9 Aktivet biologjike

S 9	Aktive biologjike		Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	aktive biologjike	9	120,833	120,833

Ne kete post te bilanci pasqyrohen si aktive biologjike ne vleren 120.833 leke aktivet drufitor te Qendres Mekanike Kucove.

#### S 10 Aktive afatgjata jo materiale

Aktive jo materiale:		10	Vlera Filltare	Amortizimi i akumuluar	Vlera e mbetur
1	Koncaskivo, palerila, lqinca, marka togtare, le drojta dhe aktive te ngjashme	10.1	0		
2	Eni i Mui	10.2	0		
3	AA,IM		58,989,660	14,168,231	44,821,429
4	Parapajime per AA,IM	10.3	0		
	<b>Totali</b>		<b>58,989,660</b>	<b>14,168,231</b>	<b>44,821,429</b>

Aktivet Afatgjata Jo Materiale ne vleren 58,989,660 leke perbehen si me poshte:

- Vlera 20,985,210 leke paraqet Pajisje software sistemi GIS
- Vlera 14,480,000 leke paraqet pajisje software "Sistemi i Centralizuar per menaxhimin e stafit dhe sherbimeve".
- Vlera 6,530,000 leke Arshiva dixhitale
- Vlera 16,994,450 leke shtese per Pajisje software sistemi GIS

Aplikanti: Kristino Zoto



## DETYRIMET DHE KAPITALI

### S 13.4 Detyrimet Afatshkurtra - Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Detyrimet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2017 paraqiten:

S13.4	Detyrime afatshkurtra-Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13.4	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Furnitore te papaguar deri 1 vit		571,837,789	995,434,599
2	Debitoro te tjere kreditoro te tjere deri 1 vit		3,329,412	6,496,891
	<b>Totali</b>		<b>575,167,201</b>	<b>1,001,931,490</b>

Furnitore te papaguar deri ne 1 vit paraqet detyrimet e shoqërisë ndaj te treteve per blerjet e mallrave apo shërbimeve te kryera gjate vitit ushtrimor.


Gjendja e furnitoreve mund ta detajojme si me poshte

S13.4	Detyrime afatshkurtra-Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13.4	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Subjekte shqiptare		42,577,365	81,575,813
2	Subjekte private		529,260,424	913,858,786
	<b>Totali</b>		<b>571,837,789</b>	<b>995,434,599</b>

Detyrimet afatshkurtra si per subjektet shqiptare ashtu edhe per ato private jane shkruar ndjeshem , si rezultat i likuidimeve ne kohe te detyrimeve kontraktuale gjate vitit 2017.

Shoqëria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e flogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e flogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin zyrtar te këmbimit ne daten 31.12.2017.

Aplikanti: *Fristino Jaka*



**S 13.8 Detyrime afatshkurtra- Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shëndetsore**

\*Të pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore \* pasqyron detyrimet ndaj punonjesve per pagat dhe sigurimet te pa likuiduara ne fund te perudhes se ushtrimit.

13.8	Detyrime afatshkurtra-Të pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	13.8	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	<i>Paga personeli</i>		101,551,046	89,427,844
2	<i>Detyrim sigurime shoq shendets deri 1 vit</i>		30,004,989	24,271,611
	<b>Totali</b>		<b>131,586,035</b>	<b>113,699,455</b>

**S 13.9- Te pagueshme per detyrime tatimore**

Te pagueshme per Detyrime tatimore deri 1 vit

13.9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	13.9	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	<i>Tatim Fitimi</i>		30,540,770	
2	<i>TVSh per tu paguar</i>		13,718,788	63,855,626
3	<i>Tatimi mbi te ardhurat</i>		24,235,606	7,321,492
4	<i>Tatim ne burim</i>		410,496	55,890
5	<i>Renta minerare</i>		17,110,956	34,370,936
	<b>Totali</b>		<b>86,016,615</b>	<b>105,603,944</b>

Te pagueshme per detyrime tatimore mbi 1 vit

13.9	Detyrime afatgjata-Të pagueshme për detyrimet tatimore	13.9	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	<i>Tatime te tjera</i>		3,535,526	3,535,526
2	<i>Renta minerare</i>			-1,538,100
3	<i>Tatim ne burim</i>		349,034	
	<b>Totali</b>		<b>3,884,570</b>	<b>1,997,426</b>
	<b>Totali pergjithshem 13.9</b>		<b>89,901,185</b>	<b>107,601,370</b>

Apolitanti:  
Festino Zoko  
*[Signature]*

S 15 Grante dhe te ardhura te shtyra

15	Te ardhura te shtyra	15	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Grante afatshkurtera		68,372,842	71,730,982
2	Te ardhura te perudhava te ardhme			
	<b>Totali</b>		<b>68,372,842</b>	<b>71,730,982</b>

Grantet jane njohur ne te ardhura ne menyre sistematike gjate perudhes kontabel.Paksimi neto i tyre per vitin 2017 pasqyrohet ne Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne shenimin S 32, te ardhura te tjera te shfrytezimit, "Te ardhura nga grantet".

S 17.1 Detyrimet afatgjata

ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2017 paraqiten:

17.1	Detyrime afatgjata	17.1	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Huamarije afatgjata		149,609,676	138,989,209
	<b>Totali</b>		<b>149,609,676</b>	<b>138,989,209</b>

Kjo huamarije ka te beje me Kredine Italiane ne kuadrin e Konventes Financiare 22 miliard lireta (Projekti COMM 98-F.ROT/AID-98/001/00), te akorduar ne lireta dhe konvertuar ne euro, e administruar nga Banka Kombetare Tregtare per Albpetrol sha dhe ish Servcom sha. Kjo hua paraqitet ne dy nga njesite e Albpetrol ne Qendren e Furnizimit te Materialeve dhe ne Qendren e Sherbimeve Gjeofizike Patos (ish Servcom).

Gjate vitit 2017, eshie likuiduar principal dhe interesa sipas dokumentit bankar paraqitur nga marreveshja midis Albpetrol sha dhe ish Servcom sha me BKT dega Tirane. Efektet e ketyre vepimeve jane paraqitur ne pozcionet financiare perkatese ne pasqyrat financiare te vitit 2017.

Aplikanti: Kristino Lelo



**S 17.4 Te Pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit**

ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2017 paraqiten si me poshte:

17.4	Te pagueshme per aktivitetin e sherbimit	17.4	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Furnitore per mallra, produkte e sherbime mbi 1 vit	1	8,166,629,633	8,198,026,286
2	Debitor, kreditor te tjere mbi 1 vit	2	61,895,967	61,249,713
	<b>Totali</b>		<b>8,228,525,600</b>	<b>8,259,275,999</b>

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit paraqesin detyrimet e shoqerise ndaj te treteve per blerjet e mallrave apo sherbimeve ne daten e mbylljes se bilancit.

Furnitore per mallra e sherbime mbi 1 vit mund ti detajojme si me poshte

17.4	Detyrime afatgjata-Te pagueshme për aktivitetin e shfrytezimit	17.4/1	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Armo sha		6,312,329,019	6,312,329,019
2	Subjekte shtetërore		161,448,555	175,210,356
3	Subjekte private		1,692,852,059	1,710,486,911
	<b>Totali</b>		<b>8,166,629,633</b>	<b>8,198,026,286</b>

Ne postin 3.1 "Te drejta te arkelueshme nga aktiviteti i shfrytezimit", Shoqeria Armo sha, i detyrohet Shoqerise Albpetrol sha 11,682,491,639 leke, ndersa ne postin 17.4/1 "Detyrime afatgjata -Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit", Shoqeria Albpetrol sha i detyrohet shoqerise Armo sha 6,312,329,019 leke, pra ne vlerë neto, Shoqeria Armo sha i detyrohet shoqerise Albpetrol sha 5,370,162,620 leke.

Ky detyrim eshte ndjekur me procese gjyqesore te cilat jane filuar nga shoqeria Albpetrol sha dhe po ekzekutohen nga shoqeria pembarimore TDR Group.

Aplibartti: Kristina Kolca



### S 17.7 Te tjera detyrime afatgjata (K/parti)

Te tjera detyrime afatgjata (K/parti) paraqiten si me poshte:

17.7	Te tjera detyrime afatgjata (K/parti)	17.7	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	k/parti AAM pa perfshire ne kapital		140,752,804	140,752,804
2	k/parti per asetet pa vlere perdorimi		336,600	336,600
3	k/parti per asetet e NJ.Z.I. ne privatizim		99,009,456	99,009,456
	<b>Totali</b>		<b>240,098,860</b>	<b>240,098,860</b>

1-Shuma 140,752,804 leke paraqet fondin K/parti per asetet e NJ.Z.I (ne privatizim),ne momentin e bashkimit te Albpetrol me Uzina Mekanike.(Raporti i zmadhimit te kapitalit te Albpetrol sha qe vjen nga bashkimi me perthithje i shoqerise Albpetrol sha te Uzines Mekanike Patos dhe Uzines Mekanike te Naftes Kucove ).

2-Shuma 336,600 leke paraqet fondin k/parti per asetet pa vlere perdorimi te QMN Kucove(Uzina Mekanike Naftes Kucove), te trasheguar nga momenti i shkeputjes nga Shoqeria Servcom sha.

3-Shuma 99,009,456 leke paraqet vleren e aseteteve ne Transnalla Patos,qe nuk generojne te ardhura.Mosperfishirja ne shumen e zmadhimit te kapitalit te vleres se ketyre aseteteve ,eshte motivuar nga fakti se keto aktive nuk do ti sherbejne aktivitetit te ardhshem te kompanise.Baza ligjore e ketyre veprimi eshte VKM nr.784,dit 15/09/2006 pika 6.(raporti zmadhimit te kapitalit te Albpetrol sha qe vjen nga bashkimi me perthithje te shoqerive Albpetrol sha , Servcom sha Fier dhe Transnalla Patos ).

### S 17.8 Dividende te pagueshme

17.8	Detyrime afatgjata-Të tjera të pagueshme	17.8	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Divident per tu paguar mbi 1 vit	17.8	2,882,966,924	2,988,966,924
	<b>Totali</b>		<b>2,882,966,924</b>	<b>2,988,966,924</b>

Vlera 2,882,966,924 leke paraqet dividentin e papaguar si me poshte:

Ne vitin 2017, eshte kryer pagese per dividentin ne shumen 106,000,000 leke.

### S 20 Provizione

S20	Provizione	20	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Provizione te tjera	20.2	30,000,000	30,000,000
	<b>Totali</b>		<b>30,000,000</b>	<b>30,000,000</b>

Kjo vlere perfaqeson vleren e provizioneve per rrezike te ndryshme.Ne vitin 2017 shoqeria nuka ka bere shitesa per kete lloj provizion.

Ky provizion nuk eshte flogaritur nga shoqeria Albpetrol, por rezulton nga bashkimi me perthithje i Uzines Mekanike Patos dhe Transnalla Patos me Shoqerine Albpetrol sha ,respektivisht 15,000,000 leke Uzina Mekanike Patos(QSHGJ) si dhe 15,000,000 leke Transnalla Patos (OT Patos).

Aplikanti: Kristino Jaka

*(Signature)*

S 23 Kapitali i nenshkruar

S23	Kapitali nenshkruar	23	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	kapitali nenshkruar	23	14,701,929,000	14,701,929,000
	<b>Totali</b>		<b>14,701,929,000</b>	<b>14,701,929,000</b>

Numri total i aksioneve me 31 dhjetor 2017 është 14,701,929,000 aksione me vlerë nominale 1,000 leke/aksion.

Kapitali i nenshkruar i shoqërisë është i njëjti me atë që rezulton në QKR në datë 31/12/2017.

Emri i Aksionerit	Numri i pjesëve	Vlera e aksionit	Vlera e aksioneve
MINISTRIA E ENERJISE DHE INDUSTRISE	14,701,929	1,000	14,701,929,000
<b>Total</b>	<b>14,701,929</b>	<b>1,000</b>	<b>14,701,929,000</b>

S 24 Prime të lidhura me Kapitalin

S24	Primi i lidhur me kapitalin	24	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Primi i lidhur me kapitalin	24	-147,190,368	-147,190,368
	<b>Totali</b>		<b>-147,190,368</b>	<b>-147,190,368</b>

Primet e lidhura me kapitalin me 31.12.2017 paraqiten në vlerën -147,190,368 leke. Në krahasim me vitin e kaluar primi i lidhur me kapitalin nuk ka ndryshuar.

Aplikanti: Kristino Jato





### S 25 Rezerva rivleresimi

Rezerva rivleresimi ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2017 paraqiten:

S25	Rezerva rivleresimi	25	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Rezerva rivleresimi	25	43,062,377,057	43,201,518,459
	<b>Totali</b>		<b>43,062,377,057</b>	<b>43,201,518,459</b>

Rezerva rivleresimi ne vitin 2017 eshte zvogeluar me 139,141,402 leke si me poste

Rezerva rivleresimi 31/12/2016 43,201,518,459 leke

-116,322,293 leke ne Qendren e Administrimit dhe Ruajtjes se prones per AAM te nxjerra jashte perdorimit  
-22,819,109 leke ne Qendren e Prodhimit te Naftes Kucove, per paksim AAM.

Rezerva rivleresimi 31.12.2017 43,062,377,057 leke.

### S 26 Rezerva te tjera

S26	Rezerva te tjera	26	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Rezerva ligjore	26.1	538,768,533	538,768,533
2	Rezerva te tjera	26.3	909,718,506	909,718,506
	<b>Totali</b>		<b>1,448,487,039</b>	<b>1,448,487,039</b>

#### Rezerva ligjore

Rezerva ligjore ne 31.12.2017 paraqitet ne shumen 538,768,533 leke.

#### Rezerva te tjera

Rezerva te tjera ne 31/12/2017 paraqitet ne shumen 909,718,506 leke . Ne krahasim me vitin e kaluar Rezerva ligjore dhe Rezerva te tjera nuk kane ndryshuar.

Aplikanti: Kristina Joto  
/e

S 27 Fitimi i pashperndare

S27	Fitimi i pashperndare	27	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Fitimi i pashperndare	27	-347,669,124	-1,880,101,372
	<b>Totali</b>		<b>-347,669,124</b>	<b>-1,880,101,372</b>

Fitimi i pashperndare paraqitet ne shumen -347,669,124 leke dhe ne krahasim me vitin e kaluar eshte rritur me 1,532,432,248 leke per rezultatin e vitit 2016.

S 28 Fitim/Humbja e vitit

S28	Fitim/Humbja e vitit	28	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Fitim/humbja e vitit	28	-405,004,815	1,532,432,248
	<b>Totali</b>		<b>-405,004,815</b>	<b>1,532,432,248</b>

Fitimi i vitit ushtrimor rezulton -405,004,815 leke.

S 29 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

S29	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	29	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Te ardhura nga shitja e produktit te gatshem e mallrave</i>		6,676,764,749	2,254,945,978
	<b>Totali</b>		<b>6,676,764,749</b>	<b>3,257,930,890</b>

Te ardhura nga shitja e produktit dhe mallrave i detajojne si me poshte:

<i>Nga shitja e naftes</i>		5,591,118,182
<i>Nga shitja e gazit</i>		7,607,000
<i>Nga shitja e energjise</i>		712,841,881
<i>Shërbime te tjera</i>		365,197,686
<b>Totali</b>		<b>6,676,764,749</b>

Aplikanti: Kristino  
Jako  
Kra

## S 30 Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces

S30	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	30	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces</i>		-2,130,149,006	1,285,401,536
	<b>Totali</b>		<b>-2,130,149,006</b>	<b>1,285,401,536</b>

Gjendja e produktit të gatshëm dhe në proces me :

01/01/2017 2,285,162,244 leke  
31/12/2017 997,592,276 leke

**Diferenca -1,287,569,968 leke**

Ne pasqyrat financiare, ndryshimi i gjendjes së produktit paraqitet në shumën -2,130,149,006 leke.

Diferenca prej 842,579,038 leke pasqyrohet :

1-Fitot brenda normave ligjore të transportimit dhe magazinimit të produktit të gatshëm në Qendren e Administrimit dhe Shitjes së Naftës (QASHNG) në shumën 8,305,499 leke

2-Vlerësimin e produktit të shpërndarë gjendje pranë kontraktoreve në dt 31.12.2017, në shumën -850,884,537 leke

Bazuar në SKK1 "Ndryshimet në inventarin e produktit të gatshëm dhe punës në proces", paksimet e pozicioneve njihen si shpenzime dhe ritjet e pozicioneve si paksim i shpenzimeve.

Për gjendjen më 31/12/2017, kemi paksim të inventarit të produktit gjendje pranë kontraktoreve në vlerë, nga 3,348,670,119 leke në 31/12/2016, në 2,497,785,582 leke më 31/12/2017.

## S 31 Puna e kryer nga njësitë ekonomike dhe e kapitalizuar

S31	Puna e kryer nga njësitë ekonomike dhe e kapitalizuar	31	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Puna e kryer nga njësitë ekonomike dhe e kapitalizuar</i>		12,192,874	100,941,447
	<b>Totali</b>		<b>12,192,874</b>	<b>100,941,447</b>

Aplimentant:

Fristino  
Joko  
Koe

S 32 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

S32	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	32	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Qera e zakonshme		3,789,546	7,166,460
2	Shitje brenda grupit		153,431,752	70,492,651
3	Shitje skrapit		0	52,961,663
4	Konsum vetjak		24,833,396	21,545,292
5	Teprica inventari		88,462	67,598
6	Te tjera		356,461	6,858,183
7	Shitje mall stok		3,176,505	0
8	Gjoha, penalitete		7,020,734	4,677,444
9	Interesa		0	0
10	Te ardhura te tjera		11,564,790	10,827,580
11	Te ardhura nga bonuset		0	5,371,024
12	Te ardhura nga shitja AAM		0	22,500
13	Te ardhura nga grantet		3,358,140	4,120,910
14	Te ardhura nga produkti i shoqense, gjendje prane kontraktoreve		0	1,556,178,471
15	Rrimarje provizionesh		6,374,442	0
	<b>Totali</b>		<b>213,994,228</b>	<b>1,740,289,776</b>

S 33 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet paraqiten si me poshte:

S33	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33.1	-1,151,464,277	-931,306,279
	Te tjera shpenzime	33.2	0	0
	<b>Totali</b>		<b>-1,151,464,277</b>	<b>-931,306,279</b>

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqet shpenzimet që kryen për blerjen e karburantit, të energjisë elektrike, si dhe materiale të tjera të konsumueshme, që i nevojiten procesit të prodhimit.

Aplikanti:  
Kristina Koca  
Koca

S 34 Shpenzime të personelit

S34	Shpenzime të personelit	34	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Paga dhe shpërblime</i>	34.1	-1,770,570,055	-1,313,781,473
	<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)</i>	34.2	-205,647,223	-171,727,159
	<b>Totali</b>		<b>-1,976,217,278</b>	<b>-1,485,508,632</b>

Shpenzimet e personelit perbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore

Nr. mesatar vjetor i punonjesve :

per vitin 2017 2277 punonjes

per vitin 2016 1857 punonjes

S 36 Shpenzime konsumi dhe amortizimi

S36	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		-312,196,618	-484,898,670
	<b>Totali</b>		<b>-312,196,618</b>	<b>-484,898,670</b>

Shpenzimet per amortizimin paraqiten ne bilanc ne shumen 312,196,618 leke dhe perfaqeson amortizimin vjetor te AAM.

## S 37 Shpenzime të tjera shfrytëzimi

S37	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	37	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
1	Renta minierare		-562,363,738	-152,192,173
2	Gjaba dhe demshperthime		-351,621,765	-303,818,278
3	Takse dhe tarifa vendore		-202,027,548	-185,009,464
4	Shpenzime transporti për materiale		-95,689,147	-27,870,203
5	Vlera kontabël neto e AAM-ve		-77,091,126	-11,240,418
6	Shpenzime auditimit bilanci dhe të tjera		-73,050,849	-63,567,170
7	Shpenzime ruajtje objekti		-69,260,782	-37,670,543
8	Punime e shërbime nga të tjerë		-55,894,400	-3,218,771
9	Sigurim jete dhe pasurie		-34,512,734	-67,592,975
10	Konsum vetjak		-24,833,396	-21,545,292
11	Blerje të pastokueshme (solar,vaj kompresion)		-18,679,618	-16,861,001
12	Shpenzime për objekte dhe mjete me qera		-13,907,872	-140,210
13	Transferime, udhëtime e dëfta		-13,690,853	-6,350,557
14	Regjistruim pasurie		-13,195,218	-2,402,970
15	Taksa aktipadi		-12,986,894	-5,698,070
16	Firo		-8,298,535	-5,038,000
17	Shpenzime transporti për personelin		-8,194,390	0
18	Të tjera		-7,167,630	-4,498,753
19	Subvencione të dhëna		-6,580,376	-7,900,000
20	Shpenzime monitorim mjedial		-6,560,792	-13,809,977
21	Taksa e regjistrimit		-5,818,220	-5,982,120
22	Personel jashtë njesise		-5,483,658	-2,717,800
23	Sigurimion automjetesh		-5,367,719	-9,268,267
24	Publicitet, reklama		-5,355,341	-4,677,919
25	Ndihma ekonomike		-4,669,755	-3,968,000
26	Shpenzime për prapje e perfaqesime		-4,122,612	-2,553,466
27	Shpenzime postare e telekom		-4,047,728	-3,141,142
28	Shpenzime të tjera		-2,575,269	-2,818,970
29	Kerkime dhe studime		-2,012,219	-1,497,427
30	Trajtime të përgjithshme (energj.ujë)		-2,086,750	-1,218,260
31	Mirëmbajtje, riparime		-1,917,481	-684,087
32	Shpenzime për leje Mjedisore		-1,540,200	
33	Shpenzime për shërbimet bankare		-1,098,278	-440,235
34	Shpenzime kalibrim roz nafte		-556,000	-625,000
35	Kancelari		-126,950	-176,544
36	Demolim skrap			-21,201,520
37	Demolime			-2,220,673
38	Antidote			-664,117
39	Vlera kontabël neto e Aktiveve Afatgjata të shdura			-280,079
40	Inventar i imet jashtë përdorimit			-2,888,130
	<b>Totali</b>		<b>-1,692,385,843</b>	<b>-1,003,448,581</b>

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit

Aplikanti: Kristina Kolco  


S 38 Te ardhura te tjera

S38	Të ardhura të tjera	38	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Interesa të arketueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme</i>	38.3	171,221	56,015,673
			171,221	56,015,673

S 40 Shpenzime financiare

S40	Shpenzime financiare	40	Viti Ushtrimor 31.12.2017	Viti Ushtrimor 31.12.2016
	<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</i>	40.1	-15,174,096	
	<i>Shpenzime të tjera financiare-Humbje nga Korvetësi</i>	40.2	0	
			-15,174,096	0

Ne postin shpenzime interesi paraqiten interesat e Kredise Italiane ne kuadrin e Konventes Financiare 22 miliard lireta(Projekti COMM 98-F-ROT/AID-98/001/00), te akorduar ne lireta dhe konvertuar ne euro, e administruar nga Banka Kombetare Tregtare per Albpetrol sha dhe ish Servcom sha, sipas marreveshjes dypaleshe me BKT.

Shoqeria Albpetrol sha per arketimin e debitoreve per detyrimet e prapambetura, Armo sha, TransAtlantic Albania ltd, Phoenix Petroleum, Delvina Kompani, po ndjek procese gjyqesore, ku ne aktipadi ka percaktuar edhe kamatvonesat te cilat percaktohen nga ekspertet kontabel vleresues rast pas rasti.

S 43 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Nr	Shpenzimet e tatim fitimit	Viti Ushtrimor 31.12.2017
1	<i>Fitimi i ushtrimit</i>	- 374,464,046
2	<i>Shpenzime te pajohura</i>	578,009,177
3	<i>Fitimi tatimor i ushtrimit</i>	203,605,132
4	<i>Fitimi i pasqerodare</i>	
5	<i>Fitimi i ushtrimit</i>	30,540,770

Shpenzimet e pajohura: paraqesin gjoba e derriqperblime, dhurime ne natyre, paksim AAM etj...

**Ngjarje pas dates se bilancit**

Shoqëria Albpetrol sha, gjate vitit 2018 i është nënshtruar kontrollit financiar nga Drejtoria e Tatim Faguesve të Mëdhenj për periudhën nga Prill 2013 deri në Qershor të vitit 2017. Ky auditim është kryer sipas Lajmerim Kontrollit nr.1172 prot. Dt.29.01.2018. Në përfundim të kontrollit të ushtruar, me shkresën Nr.1172/6, datë 13.07.2018 "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore", rezulton se Albpetrol sh.a duhet të paguajë për periudhën e audituar, detyrime në vlerën 930,501,960 (nëntëqind e triqindë mijë e pesëqind e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, nga ku detyrim principal në vlerën 655,643,186 lekë dhe gjaba 274,858,774 lekë.

Aplikanti: Kristina Koto  
Koto